

Vetura / Motoçikleta

Zvicra ka një rrjet rrugësh të të zhvilluar mire. Përdorimi i shumicës së rrugëve është pa pagesë. Rregullat e trafikut kanë një rëndësi të madhe. Nëse ato nuk respektohen, gjobat janë të larta.

Rregullat e qarkullimit

Rregullat e qarkullimit në trafik kanë një rëndësi të madhe për shoferët në Zvicër. Krahasuar me vendet tjera, gjobat janë shumë të larta. Për shkelje të rënda të rregullave, mund të heqet patentshoferi.

Disa rregulla të rëndësishme:

- Shpejtësia maksimale mbrenda vendbanimit: 50 km/h; jashtë vendbanimit: 80 km/h, autostradë: 120 km/h.
- Në autostradë është i ndaluar tejkalimi nga e djathta.
- Dritat e automobilit duhet të jetë e ndezur edhe gjatë ditës.
- Të gjithë personat në automobil duhet të jenë të lidhur me rripin e sigurisë.
- Fëmijët duhet të jenë në një karrocë për fëmijë (deri në moshën 12 vjeçare ose fëmija ta ketë një gjatësi prej 150 centimetrash).
- Telefonimi gjatë qëndrimit në timon është i lejuar vetëm me pajisje që nuk duhet mbajtur në dorë (dëgjuese ose interfon)
- Është e ndaluar të drejtohet automobili nën ndikimin e alkoolit ose drogës (kufiri i promilave është 0.5).
- Këmbësorët në zebra kanë gjithmonë përparësi (përveçse nëse kalimi është rregulluar me një sinjalizim drite).

Taksat për rrugë

Rrugët financohen prej, shteti, kantoneve dhe komunave. Shfrytëzimi i rrugëve është pa taksa. Përrjashtim bëjnë autostradat: Kush don ta shfrytëzoj autostraden duhet ta blej një taksë autostrade (Vignette). Ekzistojnë vinyeta ngjitëse dhe e-vinyeta. Vinyeta ngjitëse ngjitet në xhamin e përparmë dhe mund të blihet në pikat e karburantit, në postë ose në zyrat e trafikut rrugor. E-vinyeta mund të blihet online.

Sigurimi

Në Zvicër guxojnë të përdoren vetëm automjetet të cilat janë të siguruara. (Sigurimet për automjete-sigurimi privat me detyrim zhdëmtimi Motorfahrzeug-Haftpflichtversicherung) ofrohet nga sigurime të ndryshme private. Sigurimi paguan për dëmet në gjësende dhe persona, të cilat shkaktohen me automjet. Për dëmet në veturen private ka sigurime shtesë vullnetare (sigurime kasko, Kaskoversicherung). Kujdes: Nëse dikush sillet me pakujdesi, sigurimi sipas rrethanave nuk paguan (p.sh ngasja nën ndikim të alkoolit-apo drogës). Sigurimi i automjeteve nuk është në sigurimin privat me detyrim zhdëmtimi i integruar Privat-Haftpflichtversicherung.

Importi i një automjeti

Kush don ta importoj në Zvicër një automjet duhet ta lajmëroj në zyrën kufitare për doganim. Automjeti duhet të vërtetohet edhe teknikisht. Njeriut i nevojitet një sigurim privat me detyrim zhdëmtimi për automjete, një patentshofer i Zvicrës dhe tabela me numra të Zvicrës. Informacione të sakëta merrni te (zyra për komunikacion rrugor, Strassenverkehrsamt) të kantonit të Appenzell Ausserrhoden. Kontrolloni para importit nëse automjeti mund të regjistrohet në Zvicër – kështu shmangni probleme dhe vonesa.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/levizshmeria/vetura-motocikleta